

BRIKENA LIKO

ÇËSHTJE TË SINTAGMAVE LIDHËZORE NË DISA ROMANE BASHKËKOHORE NË GJUHËN SHQIPE¹

Në këtë trajtesë jemi ndalur shkurtimisht te struktura e sintagmave lidhëzore në gjuhën shqipe, si gjenerohen ato në mendjen e folësit të shqipes, si dhe vendi e roli i tyre në strukturën e përbërësit më të madh ku bëjnë pjesë.

Sintagmat lidhëzore (SL) janë ato sintagma që kanë si kokë të tyre një lidhëz nënrenditëse, kategori funksionale kjo që i paraprin një fjalie të varur dhe që luan një rol mjaft të rëndësishëm në organizimin e frazës.²

Funksioni i përgjithshëm i SL-ve është bashkërenditës ose nënrenditës. Një SL është kokë funksionale e sintagmës kohore (SKoh)³, që është komplement i saj. SL-të përcaktojnë nëse një sintagmë kohore është pjesë e një sintagme më të madhe, ndërsa lloji i elementit që zë pozicionin e specifikuesit apo të kokës së kësaj sintagme, tregon edhe natyrën e sintagmës kohore që pason (p.sh., nëse është pohim apo pyetje), gjë që rrjedhimisht tregon edhe mënyrën se si lidhet kjo me përbërësit sipër

¹ Vëzhgime dhe analiza mbi një material të vjelë nga disa romane të shkrimtarit bashkëkohor Zija Çela.

² Në literaturën anglisht i përgjigjet termi *CP – complementizer phrase*, në literaturën italisht *sintagmi del complementatore*. Në këtë trajtesë është përdorur termi shqip *sintagmë lidhëzore* (sipas L. Buxhelit, “Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe”, Neraida, Tiranë, 2007 dhe sipas A. Kananaj (2005). Por të përshtatshëm na duken edhe termat *komplementues* dhe *sintagmë komplementuese*, përdorur nga Turano (*Hyrje në gramatikën gjenerative*, SHBLU, Tiranë, 2011), dhe nga R. Memushaj te “Gjuhësia gjenerative”, SHBLU, Tiranë, 2003, sepse lidhet me faktin që fjalia që ajo paraprin shërben si komplement i një sintagme të fjalisë drejtuese. Gjithsesi edhe termat *lidhëz – sintagmë lidhëzore*, duke qenë se në kokë të këtyre sintagmave janë lidhëzat nënrenditëse, janë të përshtatshëm. Këtu do të përdoren si sinonime të njëra-tjetrës. Një tjetër term është ai që ka ardhur në përkthimin shqip të Graffi-t nga B. Topalli: *përplotësues*.

³ Shkurtim për *SKoh – sintagmë kohore*, frazë me folje të shtjelluar, meqenëse i tillë është sjellë në shqip. Në të vërtetë, pavarësisht se kështu mund të përkthehet nga ang. *tense phrase* (TP), ky term nuk i referohet vetëm elementeve që tregojnë kohën, por që tregojnë shtjellimin në përgjithësi, ndaj edhe përkon me *IP – Inflection phrase* në teorinë e drejtimit dhe lidhjes, që e tregon më mirë këtë tipar.

saj. Sipas Graffi-t⁴, lloji i kokës së sintagmës lidhëzore realizon edhe atë që ai e quan modalitet të fjalisë që pason.

Një përshkrim i përgjithshëm i rolit të SL-ve është ai i Elly Van Gelderen⁵, e cila dallon tri shtresa të fjalisë: shtresa më e lartë dhe e jashtme është ajo e sintagmës lidhëzore në të cilën jepet informacioni pragmatik, shtresa e mesme është ajo e sintagmës kohore, ku jepet përshtatja gramatikore, dhe shtresa më e brendshme është ajo e sintagmës foljore, e cila jep informacion leksikor dhe tematik. Pra, shtresa e jashtme, ajo e sintagmës lidhëzore, është përgjegjëse për kodimin e informacionit të ligjëritimit dhe për lidhjen e një fjalisë me një tjetër.⁶ Ky funksion i këtij përbërësi, rëndësia e tij në strukturën dhe kuptimin e gjithë frazës, si një pikë lidhëse shumë e rëndësishme midis përbërësve të një fraze të përbërë, është i tillë për të gjitha gjuhët, rrjedhimisht edhe për shqipen.

Mënyra se si gjenerohen sintagmat lidhëzore në mendjen e folësit amtar të shqipes lidhet me funksionin sintaksor që do të kryejë ajo sintagmë në përbërje të frazës më të madhe dhe sidomos në raport me fjalinë e vet drejtuese dhe përbërësit e saj. Kështu p.sh., sintagmat lidhëzore në rolin e argumenteve të foljes së fjalisë drejtuese, gjenerohen si komplementë të asaj sintagme foljore. Vendi i tyre në variantin përfundimtar në sintaksën e shfaqur përftohet nëpërmjet operacioneve të ndryshme gjuhësore, si p.sh. lëvizja. Ky vend varet dhe ndikohet nga shumë elemente të tjera, ndër të cilat mund të përmendet, p.sh., aspekti pragmatik (nëse SL-ja është në pozicionin e remës apo temës). SL-të në gjuhën shqipe janë të shumëllojshme qoftë për nga ndërtimi, funksioni etj., prandaj për secilin rast ose grup rastesh mënyra e gjenerimit ndryshon, ndaj nuk mund të shqyrtohen në këtë trajtesë të shkurtër.

Për shembull, në fjalinë e mëposhtme, sintagma lidhëzore është komplement i sintagmës foljore që ka si kokë foljen *dua*. Funksioni është ai i kundrinorit, argument i foljes së fjalisë drejtuese. Kjo mund të vihet re më mirë, nëse frazën e paraqesim skematikisht:

⁴ G. Graffi, *Sintaksa- Strukturat e ligjëritimit*, përkthimi shqip nga Blerta Topalli, shtëpia botuese "Dituria", Tiranë 2003, (originali *Le structure del linguaggio. Sintassi*, il Mulino, Bologna, 1994).


⁵ Elly van Gelderen, "Clause Structure", Cambridge: Cambridge University Press, 2013, f. 43.

⁶ Ndërsa shtresa e brendshme përfshihet në shenjimin e kohës dhe përshtatjes nëpërmjet mjeteve morfologjike ose nëpërmjet foljeve ndihmëse, dhe shtresa më e ulët, ajo e SF-së përcakton rolet tematike.

Donte që mikrofoni i kamerës së tij të kapte sa më qartë edhe zërin e Markut... (Zija Çela, Apokalipsi sipas Shën Tiranës)

Donte [SL₁ [- -] [L' [L⁰ që] [SKoh mikrofoni i kamerës së tij të kapte sa më qartë edhe zërin e Markut]]]

(SL me lidhëz të shprehur fonetikisht – argument – kundrinore)



Cila është struktura e sintagmave lidhëzore në gjuhën shqipe dhe cili është vendi i tyre në frazën më të madhe që e përmban?

Si kokë e sintagmave lidhëzore në gjuhën shqipe shërben një lidhës nënrenditës, e shprehur fonetikisht ose jo.⁷ Ka studime që të gjitha fjalitë e varura i konsiderojnë si sintagma lidhëzore, edhe në rastet kur kjo lidhës nuk është e shprehur fonetikisht dhe që as mund të vendoset apo të nënkuptohet.⁸ Në mbështetje mendimin se, në rast se lidhëza mungon fonetikisht, por nënkuptohet ose mund të vendoset lehtësisht pa prishur kuptimin, duke gjetur vend në strukturën e fjalisë, atëherë duhet ta konsiderojmë si një sintagmë lidhëzore, ndërsa në rastet kur kemi fjali të nënrenditur, por që nuk ka lidhës dhe që vendosja e saj do të prishte kuptimin e fjalisë apo nuk do të kishte vend, atëherë nuk duhet të konsiderohet si një sintagmë lidhëzore.


⁷ A. Kananaj pohon se realizimi fonetik ose jo i lidhëzës në këto fjali nuk mund të shpjegohet me foljen që i përzgjedh ato, pasi e njëjta folje mund të përzgjedhë dy fjali të ndryshme, njërin me lidhës të realizuar fonetikisht dhe tjetrën jo (shembujt e autore: a. *Eja kur do ti*. B. *Eja që të flasim*).⁷ Sipas saj kjo të bën të mendosh se është L ajo që përzgjedh fjalinë e nënrenditur dhe përcakton modalitetin e saj dhe jo folja e fjalisë kryesore.

⁸ Koka e një sintagme është ajo që përcakton tiparet e gjithë sintagmës. Në parim ajo është e detyrueshme, sipas parimit të kokës, por në rastin e sintagmave lidhëzore çështja shtrohet ndryshe. Është diskutuar shumë mbi komplementuesit e pashprehur fonetikisht, por që gjithsesi projektojnë një sintagmë.

Për t'u diskutuar është fakti që te mjetet lidhëse në gjuhën shqipe, përveç lidhëzave futen edhe fjalët lidhëse dhe fjalët korrelative⁹, por këto dy të fundit nuk janë kokë e SL-së. Fjalët lidhëse¹⁰ mund të jenë specifikues i saj. P.sh., përemri lidhor, i cili ndryshe nga lidhëza, ka edhe një funksion sintaksor në fjali:

ai [SL që mashtrohet] duhet të dënohet

[SL [që] [L' [L Ø] [^SKoh mashtrohet]]]



Ndërtime të tjera të njëjta:

...u ndal te fotot [SL që i pëlqenin më tepër]... / ...ai shtypi butonin [SL që i duhej]... / Pastaj mblodhi bërrylat [SL që i kishte hapur në tavolinë]... (Z. Çela, Sos...) Në qytetin tonë ka shumë vajza [SL që kërcejnë]. (Z. Çela, Arkipelagu...) ... u ndal te fotot [SL që i pëlqenin më tepër]...

Gjatë lëvizjeve të ndryshme, në pozicionin e kokës mund të ngrihet edhe folja. P.sh., te foljet që kanë klitikë në trup të tyre, Turano pohon se në rastet kur klitikët gjenerohen në pozicionin kokë të sintagmës klitike, ata mund të trupëzohen me foljen, vetëm nëse kjo e fundit ngrihet në pozicionin e kokës C⁰.¹¹

Kurse fjalët korrelative në strukturën e fjalisë kanë si pozicion të tyrin atë të kokës së sintagmës, të cilën e modifikon SL-ja dhe janë pjesë e fjalisë drejtuese. Fjalët korrelative janë koka të një sintagme ndajfoljore e cila ka si plotësor SL.¹²


Ju pëlqente atëherë [SL kur Princi fliste me celular]...(Z. Çela, Goja e botës)

⁹ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, grup autorësh, “Gramatika e gjuhës shqipe 1”, Tiranë, 2002, f. 397.

¹⁰ Përemrat lidhorë e ndajfoljet lidhore, përemrat pyetës dhe ndajfoljet pyetëse.

¹¹ Turano, Koleci (2011, f. 89).

¹² A. Kananaj është shprehur se vetëm në rastin e ndajfoljeve të sasisë *aq/kaq*, duke qenë se nuk kanë një mëvetësi kuptimore, flitet për specifikues të sintagmës lidhëzore, sepse ato luajnë rolin e fjalës së shkallës dhe jo të një ndajfoljeje të mirëfilltë.




Vendi i specifikuesit të sintagmës lidhëzore mund të jetë bosh¹³, por në fjalitë e nënrenditura me folje të shtjelluar kryefjala lëviz nga pozicioni i specifikuesit të sintagmës foljore në atë të SKoh dhe në fund qëndron në pozicionin e specifikuesit të sintagmës lidhëzore. Si plotësor i tyre është gjithmonë një sintagmë kohore. Në gjuhën shqipe L mund të marrë si komplement vetëm një SKoh.

Turano sqaron se, ndërsa koka e sintagmës lidhëzore është C⁰ (komplementuesi), si komplement i saj shërben një sintagmë funksionale IP/AgrP.

Struktura e përgjithshme e sintagmës lidhëzore është si më poshtë:

[SL [][L' [L] [SKoh]]]



Cilat janë pozicionet në të cilat del sintagma lidhëzore në strukturën e përbërësit më të madh që e përmban atë?

Sintagma e fjalisë drejtuese që ka si komplement sintagmën lidhëzore, mund të ketë pozicione dhe funksione të ndryshme në frazën më të madhe. Lloji i sintagmës që ka për komplement SL-në përcakton edhe funksionin e tyre në raport me të dhe të gjithë fjalinë që e përmban.


¹³ Andrew Carnie (2006, f. 152) thotë se sintagmat lidhëzore kanë një pozicion bosh të specifikuesit, pozicion bosh që, sipas të cilit, merr një rëndësi të veçantë kur flitet për lëvizjen *wh*, pohim që ka vlerë edhe për gjuhën shqipe, siç është vënë re edhe nga Turano e të tjerë.

Kështu, gjatë analizës së shembujve kemi vënë re se SL lidhëzore në gjuhën shqipe në strukturën e sintagmës më të madhe ku ajo përfshihet, mund të shfaqet si:

SL në pozicionin e specifikuesit të sintagmës foljore. Në këtë pozicion, për nga funksioni këto SL mund të jenë p.sh., fjalitë kryefjalore. Struktura e këtyre fjalive mund të jetë si më poshtë:

Ndërtimet pësore ose me folje të tipit *ndodh*, shprehje të tipit *është mirë që* etj.

Ndodhte [_{CP} që disa vdekagjallë i ftonte në shtëpinë e vet].



Në këto ndërtime SL-ja gjenerohet brenda sintagmës foljore, si specifikues i saj dhe më tej nuk lëviz më, siç do të lëvizte kryefjala e shprehur me një sintagmë emërore për të marrë elementet e përshtatjes, por lëviz vetëm folja për të marrë elementet e eptimit¹⁴.

SL që del në pozicionin e pozicionin e adjunktëve:


Djali [që pashë në kabinë], ishte shoku i tij.

SL mund të jenë komplemente të një sintagme foljore.


...më duket se kësaj here e kam gjetur ndërmjetësin... (Z. Çela, Sos një buzëqeshje)

Unë nuk e dija [SL se nëna i ruante përgjigjet e tij].


¹⁴ Në këto raste pozicioni i specifikuesit të SKoh është i zënë nga një *pro* plotësuese, pa rol tematik (Më tepër Turano, 2011: f. 48)



Ato mallra [SL që kishin blerë], riktheheshin atje... (Z. Çela, Goja e botës)



Nuk jam aq injorant sa mund të më pandehni. (Moikom Zeqo, Refuzimi i shkrimit)



[Moh'' [-] [Moh' [Moh⁰ Nuk] [F'' [-] [F' [F⁰ jam] [Mb'' [spec. aq] [Mb' [Mb⁰ inJORant] [SL sa mund të më pandehni]]]]]]]]

Në frazën e mësipërme SL-ja është komplement i sintagmës mbiemërore.

Përfundime

Sintagmat lidhëzore në gjuhën shqipe janë sintagma me koka funksionale me kokë të shprehur fonetikisht ose jo. Funkcioni i përgjithshëm i tyre është të tregojë rolin e sintagmës kohore (SKoh) që kanë për komplement. Ato përcaktojnë nëse një sintagmë kohore është pjesë e një sintagme më të madhe kurse lloji i elementit që zë pozicionin e specifikuesit apo të kokës së kësaj sintagme, tregon natyrën e sintagmës kohore që vjen pas.

Mënyra se si gjenerohen ato në mendjen e folësit amtar të shqipes lidhet ngushtë me funksionin sintaksor që kryen ajo sintagmë në përbërje të frazës më të madhe dhe sidomos në raport me fjalinë e vet drejtuese dhe përbërësit e saj. Vendi i specifikuesit të tyre mund të jetë bosh, mund të zihet prej elementit pyetës në fjalitë pyetëse ose nga foljet që kanë klitikë në trup. Si plotësor i tyre në gjuhën shqipe mund të shërbejnë vetëm sintagmat kohore. Lloji i sintagmës me të cilën lidhet SL-ja përcakton edhe funksionin e saj në raport me të dhe të gjithë fjalinë që e përmban. SL-ja në strukturën e sintagmës më të madhe ku ajo përfshihet në gjuhën shqipe mund të shfaqet në pozicione të ndryshme, atë të specifikuesit të SF, në

pozicionin e adjunktëve, komplementëve të një sintagme foljore, komplementëve të një SE-je, të një sintagme mbiemërore ose ndajfoljore.

Trajtimi i këtij lloji sintagme është bërë në gjuhën shqipe në studime të fundit në të cilat është parë si një nga format e shprehjes së frazave me nënrenditje. Gjithsesi, mund të përfundojmë duke thënë se SL-të në gjuhën shqipe janë të shumëllojshme qoftë për nga ndërtimi, funksioni etj, prandaj trajtimi i këtyre sintagmave funksionale në shqipe kërkon punë të veçanta e të thelluara, (qoftë edhe në kuadrin e trajtimit të frazave me fjali të varura). Në këtë trajtesë është bërë veçse një paraqitje e sipërfaqshme e karakteristikave kryesore që shfaqin ato në gjuhën shqipe.

BIBLIOGRAFI

- Buxheli, L. (2007), *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*. Tiranë: Neraida.
- Carnie, A. (2006), *Syntax, A Generative Introduction* (bot. i botimi i dytë). Oxford: Blackwell Publishers Ltd.
- Gelderen, E. van, *Clause Structure*, Cambridge: Cambridge University Press, 2013.
- Graffi, G. (2003), *Sintaksa - Strukturat e ligjëritimit*. (B. Topalli, Përkth.) Tiranë: Dituria.
- Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia*. (2002), Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Kananaj, A. (2015), *Rrethanori në gjuhën shqipe*. Tiranë: QMKSH.
- Koleci, F., Turano, G. (2011), *Hyrje në gramatikën gjenerative*. Tiranë: SHBLU.
- Memushaj, R. (2008, botimi i parë 2003), *Gjuhësia gjenerative*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.

Materialet

Materialet i analizuar mbi të cilin janë nxjerrë përfundime, dhe shembujt e paraqitur këtu janë vjelë nga romanet e autorit bashkëkohor shqiptar Zija Çela: “Apokalipsi sipas Shën Tiranës”(Toena, 2011), “Sos një buzëqeshje”(Ideart, 2009), “Arkipelagu Spiritus”(Toena, 2014), “Goja e Botës”(Toena, 2010).

